



FAKULTETI

I

ADMINISTRIMIT TË BIZNESIT

PROGRAMI STUDIMOR I STUDIMEVE DERI NË DIPLOMIM
(Bachelor of Arts)

EMËRTIMI I PROGRAMIT:

ADMINISTRIMI I BIZNESIT

HYRJE

Programi trevjeçar (Bachelor of Arts Program) i Fakultetit të Administrimit të Biznesit në formë unike i përgatit studentët për pozita udhëheqëse në gjithë botën, si në organizatat fitimprurëse, po ashtu edhe në ato jofitimprurëse. Ndryshimi i fundit i programeve studimore nga katërvjeçar në atë trevjeçar, rrjedh si pasojë e zhvillimit dhe ristrukturimit intensiv të programit të biznesit. Ndryshimi vjen si rezultat kryesisht i reformave në tregun e punës dhe nevojës për udhëheqës në nivele të ndryshme. Struktura e programit trevjeçar përmban studime, që nga natyra janë dinamike, integruese dhe interaktive. Këto studime pritet të japin rezultate profesionale, të përshtatshme me kërkesat të tregut të punës dhe, njëkohësisht shërbejnë si bazë e shëndoshë për studimet të mëtutjeshme në nivelin pasuniversitar. Sot, shumë organizata funksionojnë në nivel global. Për këtë arsye, programi i biznesit është i ndërtuar që të ofrojë qasje integruese të çështjeve të biznesit ndërkombëtar, duke përfshirë koncepte të biznesit ndërkombëtar gjatë tërë programit studimor të biznesit (kurikulimit). Lëndët në program prezantojnë perspektivë të bazuar në teori, që janë të lidhura ngushtë me aplikimin e tyre në botën e biznesit. Programi, pikënisje ka aftësimin e studentëve me njohuri të përgjithshme të gjuhëve lokale dhe angleze, aftësive të teknologjive informative (TI), studimeve europiane, metodologjinë kërkimore dhe aftësitë e studimit. Pastaj, studentët njoftohen me lëndët themelore të ekonomisë dhe të menaxhimit të biznesit, dhe më në fund fokusohet në lëndët e avancuara profesionale, si manaxhmenti financiar, marketingu, e biznesi, dhe lëndët zgjedhore të avancuara. Ky program mësimor është i ndërtuar t'i orientojë dhe aftësojë studentët në lëmi të caktuar dhe, në të njëjtën kohë t'i përgatis ata për studime pasuniversitare. Eksperienca e kombinuar profesionale dhe akademike e stafit të fakultetit tonë u përgjigjet sfidave të rrethanave të biznesit dhe 'ekonomisë së re'. Veçori dalluese e fakultetit të administrimit të biznesit është se stafi i fakultetit, i cili përfshinë një rreth të gjerë të profesorëve ndërkombëtarëve që vijnë nga vende të ndryshme të botës, përkrah profesorëve të njohur në rajon. Përfitim plotësues është se, studentët në semestrin e fundit janë të nxitur të marrin pjesë në punë praktike, me ç'rast u jepet mundësia të njoftohen me botën reale të biznesit. Eksperienca e fituar gjatë punës praktike, u lejon atyre të jenë në rrjedh me kolegët e tyre **në botën e biznesit në Europë dhe botë**, si dhe për të bërë vetë vlerësimin e kompetencave dhe aftësive personale.

Ndërkaq, meqë programi bazohet në akumulim të kredive nga modulet e përfshira në program, gjithashtu lejon akumulim të kredive nga universitetet tjera / lejon hyrje në program të vitit të dytë dhe në vitin e fundit të studimeve. Qasja e tillë bashkëkohore në mësimdhënie dhe pajisjet për mësim dhe mësimdhënie u përgjigjen standardeve të universiteteve të njohura në botë. Studentët tanë kanë bibliotekë të furnizuar mirë dhe

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

laborator me qindra kompjuterë me linjë interneti nëpërmjet satelitit. Departamenti i Administrimit të biznesit bashkëpunon me shumë organizata serioze të suksesshme në vend, në bazë të autoritetit që ka UEJL dhe me ekzistimin e qendrave të biznesit dhe qendrës së karrierës mban lidhje të vazhdueshme afatgjatë me shumë organizata serioze dhe të suksesshme në vend. Një aktivitet i tillë, i pozicionon të diplomuarit tanë një hap para në tregun e punës, duke ju mundësuar lehtësim në punësim dhe aplikim të njohurive të fituara në fushat përkatëse. Të diplomuarit që do të marrin titullin *'bachelor of arts'* në administratën e biznesit, do të kenë mundësi të punësohen në organizata të sektorit publik dhe privat, në sferën e funksioneve të biznesit, si udhëheqës, këshilltarë, administrator, analist financiar, kontabilist, udhëheqës të burimeve njerëzore, udhëheqës në marrëdhëniet publike, udhëheqës marketingu, studiues tregu dhe shumë pozita tjera sfiduese. Diploma, gjithashtu, ofron bazë për ndjekjen e studimeve pasuniversitare në shumë universitete të akredituara dhe shkolla të biznesit nëpër botë.

Fakulteti i Adminisrimit të Biznesit

1. Institucioni/Organi i dhënies së titullit	Universiteti i EJL
2. Institucioni mësimor	Universiteti i EJL
3. Vendi i zhvillimit të mësimit	Qyteza e UEJL (Tetovë)
4. Programi është akredituar nga:	Bordi i akreditimit
5. Shkalla përfundimtare e studimit	BA
6. Programi	Studime deri në diplomim – Administrimi i biznesit
7. Data e punimit/revizioni	Shtator 2007
8. Grupi i studentëve	Gjenerata e vitit akademik 2008/2009.
9. Qëllimet arsimore të programit	

Programi trevjeçar (*Bachelor of Arts Program*) i Fakultetit të Administrimit të Biznesit:

- I përgatitë studentët për pozitën e liderit në organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse në vend dhe gjithkund në botë;
- I përgatit studentët që të ndërtojnë karrierë në sferën e administrimit të biznesit, por edhe në sektorin privat dhe joqeveritar;
- I lidh teorinë dhe praktikën që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri themelore për ndryshimet ekonomike, politike, shoqërore dhe teknologjike, të cilat e ndryshojnë mënyrën e jetesës dhe të punës;
- I rritë aftësitë komunikuese dhe hulumtuese dhe mundëson fitimin e ekspertizave të reja në fushën e menaxhimit, marketingut dhe ekonomisë;
- Ofron një sërë modulesh që përfshijnë bazën e njohurive për afrimin me profesionet, të cilat janë ose nuk janë të lidhura me sferat e biznesit;
- Krijon kuadër të aftë, i cili do të udhëheqë me kompanitë publike dhe private, si kuadër, i cili profesionalisht është i aftë dhe kompetent të marrë pjesë në proceset integruese të vendit tonë për anëtarësim në Unionin Europian;
- Mundëson arritjen e aftësive hulumtuese dhe përvojën në menaxhment, marketing, financa, në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe në organizatat publike, private dhe jofitimprurëse;
- E krijon gjeneratën e parë të të diplomuarve në administrimin e biznesit, të cilët do t'u përgjigjen sfidave të shoqërisë bashkëkohore.
- Krijon një kuadër të aftë, të cilët do të jenë të suksesshëm që në rrethana të lira dhe

<p>demokratike të ekonomisë së tregut, të kyçen në tregun ndërkombëtar të punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • E zhvillon konceptin e të menduarit kritik tek studentët. • Mundëson që studentët aktivisht të kyçen në ligjërata dhe të bëjnë hulumtime të pavarura në të gjitha fushat e administrimit të biznesit. • Mundëson zhvillimin e aftësive personale, komunikim, hulumtim dhe aftësi të tjera të rëndësishme, që janë të nevojshme për t'u punësuar. 	
<p>10. Rezultatet nga mësimi</p> <p>Programi ju ofron mundësi studentëve që të zhvillojnë dhe të dëshmojnë njohuritë, mirëkuptimin, cilësitë, aftësitë dhe atributet e tjera në fushat e mëposhtme.</p>	
<p>Dituritë e fituara</p>	<p>Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit që përdoren për të arritur dhe demonstruar rezultatet</p>
<p>A. Njohuritë e fituara dhe parashikimet: Studentët përvetësojnë njohuri: 1. Nga sfera e administrimit të biznesit, menaxhimi, marketingu dhe financat etj.;</p> <p>2. Për të qenë të aftë dhe të posedojnë kompetencë për udhëheqje dhe për shfrytëzimin maksimal të resurseve për arritjen e dijeve të reja;</p> <p>3. Planifikimi, aplikimi të politikave të reja nga sfera e biznesit, me rëndësi për shtetin dhe shoqërinë;</p> <p>4. Për një angazhim aktiv në projekte të rëndësishme shkencoro-hulumtuese</p> <p>5. Me dijet e fituara shkencoro-profesionale, studentët janë të përgatitur për t'u punësuar në institucione të specializuara nga sfera të ndryshme të sektorit publik dhe shtetëror, privat dhe në shoqërinë civile.</p>	<p>Ligjëratat/mësimi Metodat themelore për zhvillimin e mësimin janë:</p> <p>Mësim interaktiv tradicional, organizimi i orëve për problemet juridike; punimi i seminarit nën udhëheqjen e tutorëve; hulumtim i pavarur; punë praktike (internship) në institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal dhe në sektorin joqeveritar.</p> <p>Metodat kryesore janë:</p> <p>Mësimi interaktiv tradicional, organizimi i orëve për problemet juridike; punimi i seminarit nën udhëheqjen e profesorit-mentor; hulumtim i pavarur në vlerësimin e lëndës; përgjigje nga vlerësimi i lëndës.</p>

6. Të njohë në mënyrë solide gjuhën angleze, që është (obligative), gjuhën frënge dhe gjuhën gjermane (zgjedhore) në nivel relativisht më të lartë.

Vlerësimi

Në kuadër të programit të lëndës, qëllim vlerësimi mund të jetë:

- Prania në ligjërata
- konsultime;
- Ushtrime të realizuara me sukses;
- Punë praktike e realizuar;
- Punimet e seminarit;
- Puna në terren;
- Projektet e realizuara;
- shpërblime/shpërblimet e fituara etj.

B. Shkathtësi dhe karakteristika të tjera Aftësitë e përgjithshme për transferimin e shkathtësive intelektuale.

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:

Ligjëratat/mësimi

1. T'i aplikojnë dijet e tyre të fituara gjatë studimeve, ti analizojnë çështjet komplekse nga sfera e biznesit, financave, menaxhmentit dhe marketingut, duke përdorur tri gjuhët mësimore (gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze).
2. Të njohin dhe përcaktojnë çështjet dhe problemet sipas rëndësisë së tyre.
3. T'i mbledhin dhe sintetizojnë të dhënat nga literatura profesionale në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze (burimet ndërkombëtare).

Këto shkathtësi, kryesisht zhvillohen përmes diskutimeve dhe argumentimit të punimeve të seminarit, prezantimit në debatet e lëndëve etj.

Shkathtësitë e përgjithshme zhvillohen përmes debateve të ndryshme, punës seminarike; prezantimit nëpër orë, si dhe punës praktike (internship) në institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, dhe në sektorin joqeveritar.

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

- | | |
|--|---|
| 4. T'i njohin alternativat e mundshme dhe të bëjnë zgjedhje praktike midis tyre. | Vlerësimi
Provime me shkrim, vlerësimi i prezantimeve nëpër lëndë, punimet e seminarit dhe punë praktike. |
| 5. Të shprehin procesin mësimor në mënyrë konstruktive. | |

C. Aplikimi i shkathtësive speciale:	Ligjëratat/mësimi
<p>Aplikimi dhe zgjidhja e problemeve</p> <p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:</p> <p>a). T'i dallojnë problemet nga sfera e biznesit, menaxhmentit, financave, marketingu i sektorit publik dhe privat.</p> <p>b). Të zhvillojnë analiza të përgjithshme dhe të veçanta nga sfera e biznesit.</p> <p>c). T'i elaborojnë nga aspekti shkencor dhe praktik, dallimet dhe nevojat e shoqërisë në tërësi.</p>	<p>Aftësitë për zgjidhjen e problemeve, kryesisht zhvillohet përmes përgatitjes dhe pjesëmarrjes në:</p> <p>Seminare, analiza të problemeve nga praktika, si dhe përmes punës praktike, ku studentët nga afër përballen me multidimensionalitetin e problemeve në administratën publike dhe politikën sociale. Kjo metodë mundëson ndërlidhje midis teorisë dhe praktikës, që është kusht i domosdoshëm për karrierë të suksesshme në institucionet administratës publike.</p> <p>Vlerësimi</p> <p>Bëhet nëpërmjet punimeve përfundimtare, kolokuiumeve, vlerësimit të prezantimeve nëpër lëndë, punimeve seminarike, si dhe sipas punimit të tezës dhe prezantimit publik pas mbarimit të punës praktike.</p>

Burimet, hulumtimet dhe vlerësimi	Ligjëratat /mësimi
<p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund që:</p> <p>a) Individualisht dhe në grupe të punojë në hulumtimin e formave më përkatëse për t'i plotësuar nevojat e popullatës;</p> <p>b) T'i elaborojë, nga aspekti shkencor dhe praktik, dallimet dhe nevojat e komunitetit;</p> <p>c) Të merr pjesë aktive në ndërtimin e politikës makroekonomike dhe mikroekonomike;</p> <p>ç) Të jetë i informuar dhe të kontribuojë në elaboratet shkencore dhe profesionale për njeriun dhe për komunitetin, që kanë nevojë për t'u kyçur në shoqëri dhe në shtet.</p>	<p>Ushtrimet praktike, prezantime individuale për lëndët në të dy drejtimet, sidomos për lëndën e obligueshme “Krahasimi i ekonomisë së biznesit në botë (UE dhe SHBA) dhe në Maqedoni”.</p> <p>Vlerësimi Bëhet në bazë të vlerësimit të analizave të problemeve nga praktika, në prezantimet individuale dhe grupore, të punimeve të seminarit.</p>

Ç. Shkathësitë kryesore:	
Komunikimi dhe shkrimi	Ligjëratat/mësimi
Pas përfundimit me sukses të programit studentët do të mund të:	Punimi i seminarit, prezantimet në orë, diskutimet, debatet nëpër lëndë. Gjatë vitit të parë do të mund të përvetësohet komunikimi i rrjedhshëm në gjuhën shqipe/maqedonase, si dhe zhvillimi i aftësive gjuhësore në terminologjinë e administratës publike.
a) Të përdorin, gojarisht/me shkrim gjuhën shqipe /maqedonase dhe gjuhën angleze nga sfera e biznesit.	Vlerësimi
b) Të angazhohen në dëshmitë dhe në diskutimet e çështjeve komplekse të biznesit (ekonomisë) në gjuhën shqipe/maqedonase dhe angleze, në mënyrë efikase dhe konstruktive.	Bëhet nëpërmjet punimeve të seminarit, prezantimeve nëpër lëndë, puna e realizuar praktike, kontrollimet përmes provimeve me shkrim dhe me gojë.
c) Të japin prezantim të qartë dhe koherent për një temë ose detyrë, duke përdorur drejt literaturën e grumbulluar.	
c) Të lexojnë materiale komplekse që kanë të bëjnë apo që nuk kanë të bëjnë me fushën e ekonomisë (biznesit),	
d) Ta përdorin literaturën e nevojshme të terminologjisë së biznesit në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze.	

11. Struktura dhe kushtet e programimit studimor, nivelet, modulet, kreditë, mirënjohjet

Mësimi ofrohet në bazë të rregullt (*full-time*) dhe me korrespondencë (*part-time*). Programet studimore në kohëzgjatje prej tre vjetësh (gjashtë semestra) për studimet deri në diplomim, përkatësisht 180 SETK-kredi (ECTS) dhe studime dyvjeçare (katër semestra) për studimet pasuniversitare, përkatësisht 120 SETK-kredi (ECTS).

Studentët ndjekin mësimin nga lëndët obligative dhe lëndët zgjedhore. Lëndët përfshijnë kredi, që përafërsisht korrespondojnë me 25-30 orë, nga kohëzgjatja e mësimdhënies së ligjëratave. Çdo vit duhet të fitohen 60 kredi për 1500 -1800 orë në vit. Informata më të detajuara për politikën e kredive mund të merren në Katalogun e Universitetit. Lëndët ndahen njësi semestrale. Studentët duhet t'i kryejnë të gjitha lëndët sipas zhvillimit të programit të obliguar studimor. Pjesëmarrja në ligjërata është e obligueshme dhe paraqet kusht primar që ta kalojnë lëndën me sukses. Çdo lëndë duhet të përfundojë, duke i plotësuar kërkesat e parashtruara në program (silabusin) e lëndës. Në semestrin e fundit, të gjashtin, studentët do të pajisen me dituri paktike dhe dhe shkathtësi përmes punës praktike, që është edhe kusht për të diplomuar në studimet deri në diplomim.

Për mbarimin e suksesshëm të studimeve pasdiplomike (Master), studentët duhet ta punojnë tezën e magjistraturës në semestrin e katërt të studimeve pasuniversitare, e cila duhet të mbrohet publikisht para komisionit të caktuar nga Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit.

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

PROGRAMI STUDIMOR I FAKULTEIT TË ADMINISTRIMIT TË BIZNESIT

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze (niveli 1-4, Gjuhë angleze akademike)	3	D	0	22	90	20-30
Gjuhë shqipe1/Gjuhë maqedonase 1	3	D	11	11	90	200/20-30
Shkathësitë e avansuara të TI-së	3	D	11	11	90	200/20-30
Studime europiane	3	D	11	11	90	200/20-30
Hyrje në biznes	6	D	30	15	180	200/20-30
Principet e marketingut	6	D	30	15	180	200/20-30
Principet e menaxhmentit	6	D	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze (niveli akademik 1-4 /gjuhë angleze e avansuar)	3	V	0	22	90	20-30
Gjuhë shqipe2/Gjuhë maqedonase 2	3	V	11	11	90	200/20-30
Kontabiliteti financiar (GAAP)	6	V	30	15	180	200/20-30
Mikroekonomi	6	V	30	15	180	200/20-30
Menaxhimi i Marketingu	6	V	30	15	180	200/20-30
Matematika e biznesit	6	V	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze (niveli 2-4) Gjuhë angleze për qëllime specifike 1	6	V	0	45	180	20-30
Makroekonomi	6	V	30	15	180	200/20-30
E drejta e biznesit	6	V	30	15	180	200/20-30
Menaxhimi financiar	6	V	30	15	180	200/20-30
Biznes – Kalkulues	6	V	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

<i>Semestri 4</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Gjuhë angleze (niveli 2-4) Gjuhë angleze për qëllime specifike 2	6	V	0	45	180	20-30
Statistikë	6	V	30	15	180	200/20-30
Menaxhimi i sistemeve informative	6	V	30	15	180	200/20-30
Lëndë e lire zgjedhore	6	V	30	15	180	200/20-30
Lëndë zgjedhore	6	V	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

Lëndë zgjedhore 1:

1. Standardet e kontabilitetit lokal
2. Proceset e integritetit europian
3. Zhvillimi ekonomik
4. Sjellja e konsumatorëve
5. Hyrje në programimin dhe projektimin e bazave të të dhënave *
6. Sjellja organizative

<i>Semestri 5</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Biznesi ndërkombëtar	6	D	30	15	180	20-30
Menaxhimi i operacioneve	6	D	30	15	180	200/20-30
Kontabiliteti menaxherial	6	D	30	15	180	200/20-30
Lëndë zgjedhore e avancuar	6	D	30	15	180	200/20-30
Lëndë zgjedhore e avancuar	6	D	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

Lëndët e avansuara zgjedhore 1 n 2:

1. Komunikimi afarist
2. Kërkimet e tregut
3. Financat publike
4. Dizajnimi dhe zhvillimi i produktit
5. Menaxhimi i projektit
6. Analiza sistemore dhe teknologitë e web-it
7. Pasuria e patundshme dhe investimet
8. Paraja dhe bankat

<i>Semestri 6</i>	<i>Kreditë</i>	<i>D/V</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakt.</i>	<i>Gjithsej orët stud.</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Biznesi i vogël dhe sipërmarrja	6	V	30	15	180	20-30

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

Ekonomia menaxheriale	6	V	30	15	180	200/20-30
Menaxhimi strategjik	6	V	30	15	180	200/20-30
Internship ose lëndë e avancuar zgjedhore	6	V	30	15	180	200/20-30
Lëndë e avancuar zgjedhore	6	V	30	15	180	200/20-30
Gjithsej	30				900	

Lëndë të avasuara zgjedhore 1 dhe 2:

1. Analiza e raporteve financiare
2. Analiza e vendimmarrjes
3. Financat ndërkombëtare
4. Marketingu I shërbimeve
5. Menaxhimi i burimeve njerëzore
6. E-biznesi
7. *Internship, projekt ose lëndë zgjedhore
8. **Menaxhimi I projektit të TI-së

PËSRHKRIMI I LËNDËVE

SEMESTRI 1

Shkathtësitë e avancuara të TI-së

Kjo lëndë është dizajnuar që t'i përgatisë studentët që vijnë nga mjediset e ndryshme me nevojat themelore kompjuterike për menaxhment efektiv dhe komunikim. Është destinuar që t'u ndihmojë studentëve që të zhvillojnë aftësi për inovacione teknologjike, si mjete për arritjen e përparësisë konkurruese. Një pjesë e madhe e teknologjive kanë arritur sukses të madh në fusha të ndryshe.

Studime europiane

Lënda Studimet europiane është lëndë themelore, e cila mësohet në të gjitha fakultetet e UEJL-së. Bëhet fjalë për një lëndë njësemestrare, që mësohet në semestrin e parë. Programi i kësaj lënde mbulon njohuri bazike nga:

- Europa
- Historia e Europës
- Kultura, civilizimi dhe vlerat europiane
- Identiteti european
- Institucionet e Europës etj.

Hyrje në biznes

Kjo lëndë është dizajnuar me qëllim që studentët të njihen me mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të ndërmarrjes. Megjithatë, vëmendje do t'i kushtohet funksionit financiar, të marketingut dhe organizimit të ndërmarrjes. Me këtë rast, do të shqyrtohet edhe ndikimi i ndërmarrjes ndaj komunitetit ku vepron.

Principet e marketingut

Kjo lëndë do ta studiojë rolin e aktiviteteve të marketingut në menaxhimin e organizatave. Fokusi bie në aplikimin e principeve të marketingut për zhvillimin e programeve efektive në marketingun e produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët e shfrytëzuesve industrial. Vëmendje e posaçme i kushtohet edhe shfrytëzimit të analizës së marketingut dhe sjelljes së konsumatorëve në zhvillimin e strategjive për prodhim, çmim, shpërndarje dhe promovim.

Parimet e menaxhimit

Kjo lëndë është dizajnuar që ti njohë studentët me “gjuhën e menaxhmentit” (termet dhe teoritë) dhe rolin e menaxherëve në organizatë. Studentët do t'i aplikojnë dijet e fituara në studimet e ndryshme, si dhe në raste që kanë të bëjnë me aspekte përkatëse. Kjo lëndë përfshinë: shkollat dhe teoritë kryesore të menaxhmentit, kuptimin e menaxhmentit, menaxhmentin si proces dhe funksionet kryesore të tij, si: planifikimin, organizimin, liderizmin, motivimin, menaxhimin e resurseve njerëzore dhe kontrollin.

SEMESTRI 2

Kontabiliteti financiar(GAAP)

Kjo lëndë ka të bëjë me bazat e teorisë së kontabilitetit financiar. Lënda i njofton studentët me fushën e kontabilitetit financiar dhe përfshin këto sfera: të përgjithshmen e kontabilitetit, raportet financiare – gjendjen e bilancit dhe suksesin, raportin e të hyrave, raportin për rrjedhën e të hollave dhe raportin për kapitalin pronësor, mjetet dhe obligimet etj.

Mikroekonomia

Kjo lëndë ka të bëjë me hyrjen në parimet e mikroekonomisë, shikuar si nga aspekti teorik, po ashtu edhe nga aspekti i aplikimit të tyre në organizata dhe degët industriale. Qëllimi është që të shikohet se si tregu e bën alokacionin e resurseve midis konkurrentëve të ndryshëm. Gjithashtu, insistohet që të shikohen anët e forta dhe të dobëta të sistemit tregtar dhe mënyrat e intervenimit të qeverisë në një ekonomi kapitaliste të tregut. Kjo lëndë ka për qëllim edhe njohjen e produkteve, konsumatorët dhe vendimin e çmimeve të

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

organizatave në kuadër të strukturave të ndryshme të tregut, duke përfshirë konkurrencën e përkryer, monopolin, konkurrencën monopolizuese dhe oligopolin.

Menaxhimi i marketingut

Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri nga sfera e udhëheqjes me aktivitetet e marketingut, mjedisin e marketingut dhe dinamizimin e tij, si dhe ndikimin stimulues ndaj punës së ndërmarrjeve, ‘marketing-vendimeve’, të cilat menaxherët i bëjnë në lidhje me strategjitë, që i aplikojnë, si dhe pasojat nga ato strategji, ‘marketing-planifikimin’, ‘marketing-taktikat’ dhe ‘marketing-kontrollin’. Duke u nisur nga fakti se në qendër të vëmendjes së çdo ndërmarrjeje duhet të jetë konsumatori, nevojat dhe dëshirat e tij, është e nevojshme që të sillen ‘marketing-vendime’ të drejta, si në nivel të tërësishëm të ndërmarrjes, po ashtu edhe në nivele më të ulëta të organizatës, që të mund ndërmarrja, në tërësi t’u përgjigjet kërkesave të konsumatorëve. Për këtë qëllim, duhet të kihet njohuri nga sfera e menaxhimit të marketingut.

Matematika e biznesit

Qëllimi i programit të kësaj lënde është që të studentët ta kuptojnë rëndësinë, thelbin dhe nevojën e aplikimit të metodave dhe modeleve të caktuara matematikore gjatë zgjidhjes së problemeve të shumta nga teoria dhe praktika ekonomike. Në këtë drejtim, intenca është që të vendosen dhe të thellohen dijet dhe përvoja e ekonomistëve të ardhshëm, në varshmëri aplikative dhe në korrelacion me suksesin e punës së tyre, përmes aftësisë për një analizë dhe rezonim gjithëpërfshirës kuantitativ. Kompleksiteti i materies është në nivel të kuptueshëm për studentët, kurse qasja bazohet në zhvillimin dhe përvetësimin gradual të metodave dhe modeleve matematikore, para së gjithash ajo është e orientuar në zgjidhjen e problemeve praktike, me qëllim të motivimit të studentëve në shfrytëzimin aplikativ dhe gjithëpërfshirës të materies së prezantuar.

SEMESTRI 3

Makroekonomia

Kjo lëndë paraqet hyrje në parimet e makroekonomisë dhe është pjesë e grupit të lëndëve bazike nga sfera e biznesit. Ajo i mbulon bazat e teorisë makroekonomike, në fakt teoritë, të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e ekonomisë në tërësi. Domethënë do të fokusohemi në aspekte, siç janë: BPV, papunësia, shkalla e inflacionit, lëvizjet ciklike të ekonomisë nacionale, baraspesha makroekonomike, politika fiskale, politika monetare, tregtia e jashtme etj. Nuk do të diskutohen aspektet teorike, por ato që do të ndërlidhen me realitetin në Republikën e Maqedonisë. Ne, do të fokusohemi në shkaqet dhe pasojat e çështjeve të ndryshme makroekonomike, siç janë: papunësia, suficitit dhe deficitit tregtar, lëvizja ciklike e ekonomisë nacionale etj. Qëllimi primar i studimit të makroekonomisë

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

është njohja e studentëve me këto tema, si në nivelin lokal, po ashtu edhe në atë regional dhe global.

E drejta e biznesit

Kjo lëndë e studion aplikimin e së drejtës fiskale, në drejtim të përmbushjes së nevojave personale dhe zhvillimit të karrierës. Disa nga temat që duhet të përfshihen janë: Historia e së drejtës, marrëveshjet, marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëtorit, mbrojtja e konsumatorëve, instrumentet e negocimit dhe instrumente të tjera juridike. Kjo lëndë ofron njohje të bazës së sistemit të sotëm juridik dhe ndikimin e tij tek individët. Studentët do të pajisen me dije dhe të njëjtat do t'i zbatojnë në aktivitete të ndryshme në klasë, në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik. Temat përfshijnë: drejtësinë, etikën, sistemin gjyqësor, marrëveshjet, borxhet, kërkesat dhe falimentimet.

Menaxhimi financiar

Kjo lëndë ka të bëjë me gjithë administratën dhe jo vetëm me studentët e drejtimeve financiare. Në kuadër të këtij kursi, shqyrtohen shumë aspekte, duke filluar nga shqyrtimi i thjeshtë, analizave në detaje të koncepteve të caktuara, instrumenteve dhe teknikave financiare, të cilat shfrytëzohen gjatë sjelljes së vendimeve. Qëllimi është që të njihen studentët me aktivitetet financiare të një kompanie. I kushtohet vëmendje koncepteve bazike financiare, siç janë: vlera momentale e parave, vlerësimi i mjeteve, rreziku dhe shkalla e kthimit të investimeve.

Kalkulimi i biznesit

Kjo lëndë kryesisht është orientuar në praktikë. Studentët duhet të njihen nga dijet e fituara paraprake nga sfera e algjebërës. Në kuadër të kësaj lënde, gjithashtu, studentët do të njihen edhe me konceptet teorike dhe terminologjinë shkencore.

SEMESTRI 4

Statistikë

Përmes kësaj lënde studentët do ti kuptojnë dhe do t'i aplikojnë elementet e statistikës deskriptive, teorisë së probabilitetit (gjasave), shpërndarjes së kampionëve (provave), përllogaritjen e parametrave të shpërndarjes, Përllogaritjen dhe kontrollin e hipotezave statistikore, analizën e variјanceve, analizën lineare, dhe analizën e serive kohore, regresionin e thjeshtë linear dhe korrelacionin.

Menaxhimi i sistemeve informative

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

Lënda përfshin trendet më të reja në zhvillimin e sistemeve informative dhe teknologjisë kompjuterike, të cilat janë të domosdoshme në procesin e sjelljes së vendimeve. Lënda hulumton aplikimin e MSI si mjet për arritjen e përparësisë konkurruese, si dhe aplikimin e kësaj teknologjie në sferat funksionale. Aspektet ndërkombëtare, sociale, etike, juridike dhe organizative të MSI do të studiohen në kuder të kësaj lënde. Gjithashtu, do të përfshihet edhe analizat themelore të komponentës teknologjike të kësaj sfere, që po zhvillohet me një ritëm të shpejtuar zhvillimit, ku janë të ë populuarizuar modelet afariste të internetit. Studentët do të njihen me këto aspekte të hulumtimeve në detaje, shfrytëzimin e literaturës, shfrytëzimin e internetit, studimet e rastit dhe prezantimet.

LËNDË ZGJEDHORE

Standardet lokale të kontabilitetit

Kjo lëndë i njofton studentët me standardet e kontabilitetit në sferën lokale. Lënda mbulon temat: plani kontabël në RM, mjetet, obligimet dhe kapitali, kostoja (çmimi)-shpenzimet, shpenzimet materiale, amortizimi i mjeteve themelore, rrogat, rrjedhën e prodhimit, të hyrat dhe të dalat, përlllogaritja e tatimit në fitim, caktimi i rezultatit financiar, krijimin e llogarisë përfundimtare etj. Marrë në përgjithësi, lënda ka të bëjë me kontabilitetin, konceptet e kontabilitetit të dyfishtë dhe raportet financiare.

Procesi i integrimit europian

Zgjerimi i Unionit Europian, i bazuar në integrimin europian të vendeve të tanishme dhe shteteve potenciale anëtare, është eksperimenti më përparimtar i bashkëpunimit multilateral dhe i integrimit deri më tani, dhe mu për këtë llogaritet si rasti i vetëm botëror për ruajtjen e paqes. Që të sqarohet ky sukses i madh, duhet dhënë përgjigje në pyetjet: Si funksionon UE dhe cilët janë faktorët që e përcaktojnë politikën dhe sjelljen e vendimeve? Kjo lëndë do t'i njohë studentët me bazën juridike, institucionet, politikat dhe mekanizmat e nxjerrjes së vendimeve në Unionin Europian. Do të shqyrtohen problemet kryesore të integrimit ekonomik europian dhe të procesit të zgjerimit. Me analizimin e qasjeve themelore të sferave kyçe politike (tregu unik, njësia monetare europiane, fondet strukturale, CFCEP, JFS), studentët do të mësojnë për interaksionin e institucioneve të Unionit Europian, për vendet anëtare dhe grupet e interesit, dhe përfundimisht do të jenë të aftë që t'i vlerësojnë sfidat e përditshmërisë së procesit të integrimit europian.

Zhvillimi ekonomik

Kjo lëndë ju ofron mundësi studentëve që t'i hulumtojnë dhe kuptojnë problemet e ndërlydhura me zhvillimin ekonomik. Në fund të këtij kursi, studentët do të aftësohen që t'i shfrytëzojnë dhe kuptojnë teoritë kryesore të zhvillimit ekonomik, si dhe çështjet kryesore të zhvillimit të ekonomive. Do të supozojmë se studentët i njohin parimet themelore te

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

mendimit ekonomik, me të cilat janë njohur në lëndën Principet e makroekonomisë dhe Mikroekonomisë. Do të studiohen teoritë e zhvillimit dhe do të shfrytëzohen gjatë analizës së çështjeve relevante ekonomike të ekonomive të sotme në zhvillim. Parakusht i këtij kursi është që studentët ta kenë kryer provimin në lëndët Makroekonomi dhe Mikroekonomi, para se ta dëgjojnë zhvillimin ekonomik.

Sjellja e konsumatorëve

Kjo lëndë i mbulon determinantet dhe sjelljet, të cilat ndikojnë në kërkesat e të mirave dhe shërbimeve. Karakteristikat e konsumatorëve, analiza e situatave dhe atributet prodhuese, nxjerrja e vendimeve, formimi i qëndrimit dhe ndryshimit, kognitimi, perceptioni dhe mësimi, të cilat janë elementet themelore të kësaj lënde. Gjithashtu, lënda ngërthen në vete edhe shqyrtimin e koncepteve të marketingut për pozicionimin e produktit, segmentimin, besnikërinë ndaj brendit, preferencialet në blerje dhe difuzionimin e inovacioneve. Edhe më shumë, ajo që u përmend më lartë rishikohet në kontekst të faktorëve që e rrethojnë si: aktorët ekonomikë dhe teoritë e komunikacionit si: etike, multikulturore, sociologjike, kulturore, psikologjike dhe ekonomike të fokusuar në krijimin e mikseve unike të marketingut për tregje të specializuara target.

Hyrje në programim dhe bazat e të dhënave

Kjo lëndë mbulon të gjitha fazat që përfshijnë zhvillimin e programeve të bazave të të dhënave dhe udhëheqjen, duke shfrytëzuar sisteme të avancuara dhe universale të udhëheqjes me bazat e të dhënave. Këtu, përfshihen teknika për analizën e bazës së të dhënave, siç kemi të bëjmë me marrëdhëniet ndaj subjektit dhe modelimin e tij të orientuar nga objekti, sqaron mjediset shpërndarëse të bazave të të dhënave klient/server dhe çështjet SLLL, por edhe siguron veglat për administrimin e bazave të të dhënave dhe deponimin e të dhënave.

Sjellja organizative

Qëllimi i lëndës është t'u ndihmojë studentëve që ta kuptojnë sjelljen e njerëzve në organizatat e sotme komplekse. Çështjet kryesore që përfshihen në programin mësimor janë: njeriu si individ, motivim, grupet dhe sjellja e grupeve, teoritë e lidërshit, autoriteti, fuqia, politika, kultura dhe ndryshimet në organizatë.

SEMESTRI 5

Biznesi ndërkombëtar

Kjo lëndë ka të bëjë me punën afariste ndërkombëtare, tregtinë dhe investimet e huaja, përfshirë këtu edhe diskutimet për aspektet kulturore, politike, sociale dhe ekonomike të udhëheqjes së biznesit ndërkombëtar. Këtu, përfshihen teoritë e tregtisë ndërkombëtare dhe zhvillimit ekonomik, me theks të veçantë blloqet tregtare dhe paraqitja e zhvillimit të Unionit Europian.

Menaxhimi i operacioneve

Menaxhimi operacional ka të bëjë me krijimin e produkteve dhe shërbimeve dhe dërgimin e tyre deri te konsumatorët. Duke e pasur faktin se kjo në të vërtetë paraqet tërësinë e veprimtarive të organizatave, mund të konkludohet se menaxhimi operacional ka rëndësi të madhe në punë e organizatës. Prandaj, çdo student duhet të ketë njohuri për rolin, qëllimin dhe aktivitetet e menaxhimit operacional. Marketingu mund t'i gjejë të gjithë konsumatorët dhe t'i informojë me prodhimin. Megjithatë, menaxhimi operacional bart përgjegjësi për kënaqësinë ose dëshpërimin e konsumatorëve, nga të cilët, në të vërtetë varet e gjithë organizata.

Kontabiliteti menaxherial

Kjo lëndë i përfshin temat në vijim: përlllogaritjen e shpenzimeve të prodhimeve dhe shërbimeve, llojet e entiteteve afariste, qendrat e shpenzimeve, llojet e shpenzimeve, përlllogaritja dhe kontabiliteti i shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte, analiza e *Cost Volume Profit* – pika kritike e rentabilitetit, shpenzimet e përgjithshme dhe shpenzimet variabile, buxheti master, buxheti fleksibil, buxheti kapital, kontrolli i shpenzimeve, shpenzimet, qendrat fitimprurëse dhe investuese, vlerësimi informatave afariste në bazë të informative të disponueshme (shpenzimet relevante dhe të ardhurat relevante).

LËNDË TË AVANSUARA ZGJEDHORE

Komunikimi afarist

Qëllimi lëndës është që t'i njohë studentët me shumëdimensionalitetin e komunikimit afarist, përkatësisht me rolin e menaxherëve të ardhshëm dhe mënyrën e komunikimit të tyre efektiv në organizatë dhe jashtë saj, në kontaktet me botën afariste etj. Në kuadër të mësimit të teorisë dhe praktikës së komunikimit afarist, studentët duhet ta mësojnë dhe kuptojnë rëndësinë dhe karakteristikat e komunikimit afarist, komunikimin kthyes, stilet e komunikimit, klimën komunikuese dhe barrierat e komunikimit. Vëmendje e posaçme i është kushtuar studimit të analizës transaksionale të komunikimit dhe rregullave të sjelljes në procesin e komunikimit, si në të folur, komunikimin joverbal dhe komunikimin me shkrim, përgatitjen dhe mbajtjen e fjalimeve, udhëheqjen e mbledhjeve afariste, komunikimin përmes telefonit dhe negocimi afarist, por edhe rëndësia e të dëgjuarit në komunikim. Komunikimi joverbal mësohet në detaje bashkë me dallimet interkulturne, kurse ai i shkruar përmes shkrimit të letrave dhe raporteve të ndryshme.

Kërkimet e tregut

Kjo lëndë mbulon fondamentet e hulumtimit të marketingut (aspekti hulumtues, përshkrues dhe shkaktues). Gjithashtu, lënda ngërthen edhe njohuri nga lloje të ndryshme të marketingut hulumtues (cilësor dhe sasior), si dhe probleme komplekse nga secila fazë e procesit të marketingut hulumtues, përfshirë edhe definimin e problemeve kryesore të mbështetura nga qëllimet hulumtuese me informacione, metodologji, bërja e pyetësorëve, provave, grumbullimi i të dhënave, analizat statistikore (p.sh. analiza e të dhënave/përmbajtja). Parakusht i kësaj lënde është që studentët ta kenë dhënë provimin e lëndës së Statistikës.

Financat publike

Kjo lëndë përfshin rolin e sektorit publik në ekonomi dhe në ekonominë e tregut. Kjo, është lëndë zgjedhore në programin e biznesit. Në këtë kurs, do të mësohen principet dhe fuqia e shpenzimeve publike, huaja publike dhe tatimimi, si dhe pasojat e qëllimshme dhe të paqëllimshme të këtyre politikave. Do t'i mësojmë bazat intelektuale që e arsyetojnë ekzistimin e sektorit publik dhe teorinë e ekonomisë, e cila përshkruan se cili duhet të jetë roli i sektorit publik. Përfundimisht, do të shohim se çka ndodh me sektorin publik në Maqedoni dhe se si ai reflektohet në sjelljen individuale dhe korporative të vendimeve dhe pasurisë.

Dizajnimi dhe zhvillimi i produktit

Dizajnimi dhe zhvillimi i produktit është kurs i bazuar në projekt, i cili mbulon veglat dhe modelet moderne për dizajnimin dhe zhvillimin e produktit. Baza e projektit qëndron në atë që ekipet e studentëve për menaxhim, inxhiniering dhe dizajn industrial konceptojnë, dizajnojnë dhe bëjnë prototipa të produktit fizik. Sesionet e orëve mbahen në formë të seminareve dhe ngërthejnë raste të ushtrimeve praktike që të mbështeten idetë kyçe. Temat ngërthejnë në vete identifikimin e nevojave të konsumatorëve, konceptin e gjeneratës, arkitekturën e produktit, dizajnin industrial dhe dizajnin e manufakturës.

Menaxhimi i projektit

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

Përpjekjet e organizatës për udhëheqje efektive me projekte mund t'i sigurojnë asaj fitore ndaj konkurrencës në tregun e inovacioneve. Në qarqet e sotme të biznesit të jesh i pari në treg (ndonëse edhe vetëm për disa javë), nënkupton shuma të hollash për organizatën nga aspekti i krijimit të besimit ndaj brendit dhe përvetësimit të një pjese të tregut. Për më tepër, menaxherët e projekteve në organizatat e konsaltingut, të cilat janë të aftë të planifikojnë, implementojnë dhe t'i kryejnë projektet e klientëve në kohë dhe në kuadër të buxhetit, janë ndër individët më të vyeshëm në organizatat e tyre. Ky kurs i adreson shkathhtësitë e nevojshme të bërjes menaxher i suksesshëm i projektit.

Analizat themelore të teknologjive të Web-it

Ky kurs paraqet rolin strategjik të teknologjive të informimit dhe komunikimit në ndërtimin dhe shfrytëzimin e sistemeve të informimit, si dhe integrimin e tyre në të gjitha funksionet e menaxhimit. Ky kurs, shqyrton vlerësimin e nevojave, seleksionimin e teknologjisë përkatëse, planifikimin dhe implementimin e sistemeve informative të biznesit, përparimin e ri në TI dhe çështje të lidhura me sigurinë, rreziqet dhe kontrollin. Si rezultat, kjo paraqet kursin hulumtues që është dizajnuar që t'i sigurojë studentit dije të detajuara për konceptet e terminologjisë së aplikacioneve të e-biznesit, metodologjive dhe shërbimeve. Janë prezantuar zgjidhje biznesi për furnizimet elektronike, udhëheqjen e furnizuesit dhe sjelljen me konsumatorët, tregtinë elektronike etj. Qëllimet e kursit janë që t'u sigurojë studentëve njohuri të zgjeruara të infrastrukturës teknologjike të domosdoshme për ekzistimin e e-tregtisë, zhvillimet e saj në vazhdimësi, perspektivat për proceset “çka” dhe “si” në dallimet industriale dhe çështjet juridike të sigurisë dhe privatësisë.

Pasuria e patundshme dhe investimet

Objekt studimi i programit është arritja e njohurive teorike dhe aplikative nga sfera e investimeve dhe procesi i investimeve, përgatitja e studimeve investuese, veçanërisht në elaboratin ekonomik, vlerësimin dhe zgjedhjen e projekteve të investimit, si dhe analizën e rreziqeve të lidhura me investimet.

Paraja dhe bankat

Kjo lëndë synon t'i informojë studentët me tregjet dhe institucionet financiare, dhe ndikimin e parasë në ekonomi. Shqyrtohet mënyra e tregjeve dhe institucioneve financiare dhe Banka Qendrore, zhvillimet e paradokohshme të teorisë dhe praktikës në këtë sferë. Teorikisht edhe pse ky është një kurs teorik, përpiqemi të analizojmë disa ngjarje botërore, si krizat financiare në ekonomitë në tranzicion; kriza në lidhje me skemën piramidale në Maqedoni dhe Shqipëri dhe roli i FMN-së.

SEMESTRI 6

Biznesi i vogël dhe sipërmarrja

Kjo lëndë është dizajnuar me qëllim të hulumtimit të personalitetit të sipërmarrësit dhe mënyrës së krijimit të ideve afariste inovative. Studentët do t'i shqyrtojnë planet, vetëvlerësimin dhe strategjitë operative, të cilat janë të nevojshme për të filluar biznesin e vogël. Procesi i planifikimit afarist përfshin njohjen e mundësive, zhvillimin e konceptit afarist, analizën e bërjes dhe planin e biznesit. Plani i biznesit përbëhet nga: menaxhmenti dhe plani organizativ, plani i prodhimit/shërbimi, plani i marketingut dhe plani financiar. Studentët do të pajisen me dije, aftësi, koncepte dhe strategji për të filluar me biznes të ri në fazën e hershme të sipërmarrjes. Lënda, gjithashtu ngërthen edhe blerjen e biznesit ekzistues dhe blerjen e franshizës.

Ekonomia menaxheriale

Kjo lëndë ka të bëjë me atë se si principet makroekonomike dhe teknikat kuantitative mund t'u ndihmojnë menaxherëve gjatë sjelljes së vendimeve. Temat përfshijnë parashikimet e kërkesave të konsumatorëve, analizën e prodhimitarisë dhe shpenzimet, vendimet e çmimeve optimale dhe të prodhimit, analizën sensitive dhe buxhetimin kapital. Qëllimi i kësaj lënde është që studentëve t'u prezantohet një spektër i gjerë i problemeve me të cilat ballafaqohen menaxherët. Të ballafaquar me probleme të këtilla, do të zhvillohen strategji dhe mjete për tejkalimin e tyre, duke shfrytëzuar teknologjitë kompjuterike. Mjeti ynë themelor kompjuterik do të jetë ANGEL. Qëllimi është zhvillimi i aftësive deri në shkallën *excel* që të paraqitet si mjet në procesin e kërkimit të punës.

Menaxhimi strategjik

Menaxhimi strategjik është dizajnuar për t'i njohur studentët me strategjitë dalluese, si dhe ka për qëllim t'i njoftojë studentët me atë se si arrijnë organizatat t'i tejkalojnë konkurrentët e tyre dhe të arrijnë përparësi përkatëse konkurruese. Kjo lëndë nuk ka të bëjë vetëm planifikimin strategjik, por edhe me analizën strategjike. Studentët do ta mësojnë procesin e menaxhimit strategjik, duke filluar me formulimin e filozofisë dhe misionit, vlerësimin e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, analizën e pozitës konkurruese të ndërmarrjes, metodat e analizës së industrisë dhe konkurrentëve në kuadër të saj, zhvillimin e planit dhe aplikimin e strategjisë (përkthimin e planit në aksion).

LËNDË ZGJEDHORE TË AVANSUARA

Analiza e raporteve financiare

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

Si kurs i avancuar i kontabilitetit financiar (përlllogaritjes financiare), fokusohet në analiza të raporteve për ndryshimet në kapitalin pronësor, bilancin e suksesit, bilancin e gjendjes dhe raportin e rrjedhës financiare. Temat ngërthejnë analizën e aktiviteteve financiare dhe investuese, përfitimet, rritën, vlerën ekonomike, vlerësimin e operacioneve dhe huamarrjen.

Analiza e vendosjes

Analiza e vendimeve si qëllim përfundimtar ka t'u ndihmojë atyre që sjellin vendime në lidhje me zgjedhjet reale botërore. Ky kurs i njofton studentët me teorinë dhe praktikën e analizës së vendimeve. Studenti do t'i mësojë veglat dhe metodat, të cilat i shfrytëzojnë analistët e vendimeve, me theks të veçantë të kuptuarit e asaj se nga vijnë veglat dhe metodat. Materiali bazohet në librat themelorë, shtyllat dhe përkushtimet origjinale nga sferat, të cilat janë si bazë e teorisë së vendimeve, hulumtimeve operative, shkencave të menaxhimit, ekonomizimit dhe psikologjisë së sjelljes së vendimeve.

Financat ndërkombëtare

Financat ndërkombëtare paraqesin disiplinë shkencore, e cila është në ekspansion të vazhdueshëm. Tregjet e sotme financiare në kuptimin e plotë të fjalës janë globale. Asnjë student që mëson ekonominë dhe financat nuk mund që t'i kuptojë plotësisht lëvizjet bashkëkohore të ekonomisë nacionale dhe ekonomisë botërore, pa pasur njohuri përkatëse nga financat ndërkombëtare. Temat që i përpunon kjo lëndë – problematika e lëvizjeve pagesore të bilanceve, determinantet e kurseve devizore, faktorët të cilët qëndrojnë pas rrjedhave ndërkombëtare të kapitalit, filozofinë afariste të kompanive multinacionale dhe institucionet ndërkombëtare financiare etj. – ka kohë që nuk janë lëndë e interesimit vetëm e grupeve të vogla të ekonomistëve akademikë ose e profesionistëve të specializuar. Njohuritë nga kjo lëndë paraqesin bazë për ata studentë, të cilët presin të gjejnë vende pune të ndërlidhura me investimet ndërkombëtare, bankierinë ndërkombëtare dhe aktivitete afariste multinacionale.

Marketingu i shërbimeve

Qëllimi i mësimit të lëndës është që studentët të njihen me kuptimin e marketingut në punën e ndërmarrjeve shërbyese dhe mënyrën e funksionimit në praktikë. Duke u nisur nga domosdoshmëria e aplikimit të marketingut në ndërmarrjet shërbyese, medoemos duhet të kihet parasysh dallimet midis shërbimeve dhe prodhimeve, kurse nga këtu edhe specifikat e marketingut të shërbimeve. Në kushtet e sotme, kur veprimtaritë shërbyese shënojnë

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

zhvillim të vazhdueshëm, nuk mund të anashkalohej qasja e marketingut në punën e ndërmarrjeve shërbyese dhe përmbushja e kërkesave të konsumatorëve përmes një programi të mirë të marketingut. Njësoj si tek ndërmarrjet prodhuese, ashtu edhe tek ndërmarrjet shërbyese udhëheqja e mirë e marketingut të shërbimeve është bazë për punë të suksesshme në treg.

Menaxhimi i resurset humane

Studimi i materies mësimore të kësaj lënde ju mundëson studentëve të njihen me problematikën e ndërlikuar të menaxhimit me resurset njerëzore, të njohur si proces i kryerjes së një sërë aktiviteteve dhe funksioneve me qëllim që, njeriu si burim më i rëndësishëm në organizatë, të shfrytëzohet në mënyrë më efikase dhe efektive. Në këtë kuadër, vëmendje e posaçme i kushtohet këtyre aspekteve të menaxhimit të resurseve njerëzore: konceptet e ndryshme të menaxhimit të resurseve njerëzore, përmbajtjes, qëllimeve dhe detyrave të menaxhimit të resurseve njerëzore, pozitës së menaxhimit të resurseve njerëzore të organizatës, analizës së punës, planifikimit të resurseve njerëzore, sigurimit të njerëzve për vende të reja të punës, selektimin e resurseve njerëzore, aplikimin në punë, zhvillimin profesional të resurseve njerëzore, nxitjen e suksesit në punë, zbulimin e potencialeve dhe aftësive menaxheriale dhe menaxhimin e resurseve njerëzore dhe vendeve të punës.

E-biznesi

Qëllimi i kësaj lënde është të kuptohen dhe aplikohen konceptet e biznesit elektronik (e-biznesi). Të zbulohen nevojat e biznesit për adaptim në ndryshimet konstante dhe të vazhdueshme të mjedisit, të identifikohet rëndësia e inkorporimit të teknologjisë së informacionit në proceset kyçe të biznesit, duke e përmirësuar efikasitetin e tyre në rrjedhë efikase operacionale që të transformohen në përfitime konkurruese. Të zhvillohen planifikime strategjike, administrative dhe operacionale për biznese të reja ose të përmirësohet ekzistuesja me mjetet e teknologjisë në rritje.

Menaxhimi i projektit të TI-së

Lënda Menaxhimi i projektit TI është menduar në atë mënyrë që, studentëve t'u përcjellë njohuri dhe shkathtësi të domosdoshme për kryerjen e detyrave të ndryshme nga domeni i udhëheqjes me projekte në nivele të ndryshme të hierarkisë së projekteve. Qëllimi i mësipërm do të arrihet përmes realizimit të programit të lëndës, të përbërë nga aspekti teorik dhe praktik dhe komponentët praktike, si dhe përmes punës individuale dhe ekipore të studentëve. Shtylla kryesore e kursit do të jetë mësimi teorik, nëpër të cilën studentët do të njihen me specifikat e menaxhimi i projektit TI si disiplinë, duke i fituar njohuritë e duhura për strukturimin e projektit, planifikimin dhe optimalizimin e kohës dhe shpenzimeve për realizimin e tij, përbërjen dhe koordinimin e ekipit projektues, rolin e menaxherit projektues etj. Përkaj kësaj, studentët do të stërviten ta shfrytëzojnë softuerin

Ndryshimet dhe plotësimet e programeve studimore

përkatës, me ndihmën e të cilit lehtësohet puna e projekt menaxherit, që do të prezantohet edhe përmes realizimit të detyrave praktike. Përfundimisht, gjatë mësimit studentët do të kalojnë edhe nëpër fazat e përgatitjes së projektit të hipotekave, me ndihmën e punës së pavarur, por edhe duke marrë pjesë në ekipin projektues të përbërë nga vetë studentët, ku do të mund edhe praktikisht t'i aplikojnë njohuritë e tyre që i kanë arritur gjatë kohës së mësimit.